



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-27/14-06

Prishtinë, më 29 qershor 2006, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën në fillim e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 71 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

Pjesa e parë:

1. Fjala e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Soren Jessen Petersen, drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në Kosovë.

Pjesa e punës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 15 qershor 2006,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peshkatarinë dhe akuakulturën,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Kosovë,

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik,
7. Shqyrtimi i Raportit lidhur me vërejtjet e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut në Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr. 2004/45 miratuar me 27.09.2004,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2005,
9. Interpelanca e ministrit Ardian Gjini, më kërkesë të deputetit Naser Osmani dhe dhjetë deputetëve nga rradhët e G/P të LDK-së.

1. Fjala e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, z. Soren Jessen Petersen, drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në Kosovë

Kryetari e falenderoi z. Soren Jesen Petersen për kontributin që kishte dhënë gjatë mandatit të tij në krye të administratës së UNMIK-ut. Kosova nuk do t'i harrojë kurrë të gjithë ata që e thanë të vërtetën për ne. Këtë e keni bërë edhe Ju, z. Petersen dhe u jemi shumë mirënjohës që patët guximin që ta thoni dhe ta mbronin të vërtetën.

Me angazhimin tuaj të palodhshëm keni vënë një gurë të madh dhe të fortë në themelin e institucioneve të Kosovës, me të cilin shpresoj se do të krenoheni ne edhe ju. Ju do të jeni mik i Kosovës dhe kjo çmohet shumë në traditën tonë dhe kjo është e shenjtë.

Kryetari e ftoi z. Petersen ta marrë fjalën.

Z. Soren Jessen Petersen – Falënderoj kryetarin, Kryesinë dhe Kuvendin që më kanë ftuar t'ju flas juve sot.

Unë po largohem nga Kosova pas dy vjetësh, të cilat kanë qenë vite që më kanë shpërblyer dhe më kanë lodhur, kanë qenë vite sfiduese ku është kërkuar punë e madhe nga unë. Fakti se procesi i statusit është duke u futur në fazën kryesore është një konfirmim i qartë i progresit që kemi arritur të gjithë së bashku dhe ky progres është meritë e të gjithë juve.

Sot me ju dua t'i ndaj disa nga mendimet personale. Krenohem se duke punuar me të gjithë ju kemi arritur shumë, por në të njëjtën kohë e dimë se gjatë dy vjetëve të fundit së bashku kemi kaluar disa momente shumë të vështira, disa kriza të mundshme, por gjithmonë kam besuar fuqishëm se duke u përballur me kundërthëniet dhe kundërshtitë ju forcoheni si persona, por edhe si shoqëri.

Në vazhdim z. Petersen foli për të arriturat dhe sfidat që kishte kaluar Kosova gjatë kohës që ai ishte në krye të UNMIK-ut.

Në fund, z. Petersen u falënderua për partneritetin, për miqësinë dhe për besimin që kishin treguar përfaqësuesit e institucioneve të vendit ndaj tij.

“Unë do të kthehem në Kosovë atë ditë kur ëndrra juaj të bëhet realitet dhe pres me pa durimi që t'i ndaj ato momente të mëdha me ju.”

Kryetari dha pauzë.

Pas pauzës, seanca filloi punimet sipas rendit të ditës.

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Sabri Hamiti kërkoi që Kuvendi të protestojë kundër trajtimit të dhunshëm dhe të pa përngjeshëm të Shërbimi Policor i Kosovës ndaj deputetit Emrush Xhemajli.

Kjo praktikë e trajtimit të tillë duhet të marrë fund përgjithmonë.

Ky nuk është rasti i parë, por ky është rasti më eklatant që ka ndodhur deri më tani. Kuvendi të kërkojë përgjegjësi dhe informacion për ndodhinë nga përgjegjësit e policisë së UNMIK-ut, nga përgjegjësit e policisë së Shërbimit Policor të Kosovës dhe direkt informatë nga ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës.

Xhevat Bislimi kërkoi nga ministri i Punëve të Brendshme dhe nga kryeministri i Kosovës të japin shpjegime për dhunën e ushtruar të policisë mbi protestuesit në Merdare dhe në Mitrovicë, që kishin dalë për të protestuar kundër ardhjes së kryeministrit të Serbisë në Kosovë.

Kuvendi duhet ta obligojë Qeverinë e Kosovës për të marrë masa që ta ushtrojë pushtetin e vet në tërë territorin e Kosovës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Sabri Hamiti. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;

Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi kërkon nga përgjegjësit e fushës së sigurisë të UNMIK-ut, të SHPK-së dhe nga ministri i Punëve të Brendshme informatë zyrtare për sjelljen e policisë kundër protestuesve në Mitrovicë dhe në Merdare.

1. Miratimi i rendit të ditës

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që rendin të ditës së kësaj seance t'i shtohet edhe një pikë – emërimi i anëtarëve në komisionet funksionale të Kuvendit.

Kuvendi miratoi rendin e ditës, të propozuar për këtë seancë, me propozimin e Alush Gashi.

2. Miratimi i procesverbali të seancës plenare të 15 qershorit 2006

Procesverbali i seancës plenare të 15 qershorit 2006 u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Emrash Xhemajli** pyeti ministrin e Punëve të Brendshme - Kush i ka dhënë urdhër Shërbimit Policor të Kosovës për të ndërhyrë kundër protestuesve që kishin dalë për të penguar ardhjen e kryeministrit të Serbisë në Kosovë?

Gjithashtu, ministrin e Drejtësisë e pyeti - Në bazë të cilave ligje mbrohet Serbia në Kosovë?

Ministrat duhet të përgjigjen për seancën e radhës.

Ministri **Haki Shatri** u përgjigj në pyetjen e deputetit **Ferid Agani**, të parashtruar në seancën e mëparshme, lidhur me pagesat e kujdestarisë për punonjësit e shëndetësisë.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** përsëriti pyetjen e parashtruar në seancën e mëparshme për ministrin Haki Shatri lidhur me raportimin e Administratës Tatimore të Kosovës së Kuvendit të Kosovës.

Ministri **Haki Shatri** tha se nuk ka marrë pyetje të tillë.

Deputeti **Hydajet Hyseni** kishte parashtruar tri pyetje ministrave dhe Qeverisë së Kosovës qysh vitin e kaluar.

Ministri i Pushtetit Lokal, z. **Lutfi Haziri**, ishte përgjigjur me shkrim pyetjes së deputetit **Hyadahet Hyseni** lidhur me mënyrën e shpenzimeve të mjeteve të Qeverisë së Kosovës për zbutjen e pasojave të tërmetit në komunën e Gjilanit.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. **Astrit Haraçia**, u përgjigj në pyetjen e deputetit **Hydajet Hyseni** lidhur me aktivitetin e kësaj ministri me diasporën.

Zëvendësministri për Komunitete dhe Kthim, z. **Nazmi Fejza**, u përgjigj në pyetjen e deputetit **Hydajet Hyseni** lidhur me aktivitetin e kësaj ministrie për të zhvendosurit nga Lugina e Preshevës.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** pyeti kryeministrin e Kosovës lidhur me caktimin e pagave për anëtarët e Këshillit të KRRPP-së.

Zëvendëskryeministri **Lutfi Haziri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

Deputeti **Berat Luzha** përsëriti pyetjen e parashtruar më herët për kryeministrin e Kosovës lidhur me pezullimin e Ligjit për lojërat e fatit.

Kryeministri nuk ishte i pranishëm në seancë për t'iu përgjigjur pyetjes së deputetit Luzha.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** kishte parashtruar dy pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me njohjen e stazhit të punës për punëtorët e larguar nga puna gjatë viteve të 90-ta dhe për nxjerrjen e librezave të punës.

Kryeministri nuk ishte i pranishëm në seancë për t'iu përgjigjur pyetjes së deputetit Kelmendi.

Deputetja **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku** pyeti kryeministrin lidhur me pagesat gjatë pushimit të lehonive.

Zëvendëskryeministri **Lutfi Haziri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Kollçaku.

Deputeti **Gazmend Muhaxheri** pyeti ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me dislokimin e fshatit Hade.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhaxheri.

Deputetja **Selvie Halimi** pyeti ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me caktimin e kriterëve për vlerësimin e pasurisë të banorëve të fshatit Hade.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetes Selvie Halimi.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** pyeti ministrin e Ekonomisë dhe të Financave lidhur me të hyrat nga regjistrimi i bizneseve.

Ministri **Haki Shatri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Safete Hadërgjonaj.

Deputetja **Teutë Sahatqija** pyeti ministrin e Trgetisë dhe të Industrisë lidhur me regjistrimin e ndërmarrjeve aksionare në komunën e Gjakovës.

Ministri **Bujar Dugolli** iu përgjigj pyetjes së deputetes Teutë Sahatqija.

Kryetari dha pauzë dreke.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peshkatarinë dhe akuakulturën

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, **Tomë Hajdaraj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim zëvendësministri, **Tomë Hajdaraj**, paraqiti strukturën e këtij projektligji, të radhitur në nëntë kapituj dhe i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin atë.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri, Tomë Hajdaraj, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Shaban Halimi, Berat Luzha, Xhevdet Neziraj, Teutë Sahatqija, Rifat Krasniq dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 63;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për peshkatarinë dhe akuakulturën.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Përgjegjës - Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Kosovë

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, **Lutfi Haziri**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim zëvendëskryeministri, **Lutfi Haziri**, paraqiti strukturën dhe synimet e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendëskryeministri, **Haziri**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Deputeti **Naser Osmani**, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa kërkoi që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë së Kosovës dhe Qeveria të paraqes Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin ligjit ekzistues për prokurimin publik.

Deputetët **Gani Koci, Nazim Jashari, Gjylnaze Sylja dhe Xhezair Murati** e mbështetën propozimin e deputetit **Naser Osmani**.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 13;

Kundër----- 44.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi Projektligjin për prokurimin publik. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që Kuvendit t'ia paraqesë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Kosovë nr. 2003/17.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21..

Pastaj kryetari e hodhi në votim Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----66
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim lidhur me vërejtjet e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut për Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr. 2004/45

Kryetari i informoi deputetët se Kuvendi e kishte miratuar Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr. 2004/45 më 27 shtator 2004 dhe i ishte proceduar PSSP-ës për shpallje më 21 tetor 2004.

PSSP-ja nëpërmjet Zyrës Ligjore i ishte drejtuar Kuvendit me disa vërejtje duke kërkuar sqarime plotësuese për disa dispozita të këtij ligji.

Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport i ka shqyrtuar vërejtjet e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut dhe Kuvendit i ka paraqitur raport lidhur me to.

Kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit për Arsim që ta arsyetojë raportin para deputetëve.

Enver Hoxhaj, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, tha se në raportin e Komisionit janë përfshirë vërejtjet e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut për Ligjin për të drejtat e autorit dhe për të drejtat e përafërta nr. 2004/45.

Ai pati vërejtje të natyrës teknike në tekstin në gjuhën shqipe që kishte pasur disa lëshime gjuhësore krahasuar me tekstin në gjuhën angleze, që e kishte hatuar Zyra Ligjore e UNMIK-ut. Teksti në gjuhën shqipe duhet të harmonizohet me tekstin në gjuhën angleze, të cilin duhet ta bëjë administrata e Kuvendit.

Ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin raportin e Komisionit për Arsim.

Kryetari e hodhi në votim raportin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport për Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr. 2004/45. rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----58;
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi raportin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me vërejtjet e Zyrës ligjore të UNMIK-ut për Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr. 2004/45.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik

Kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa të jep vlerësimin lidhur me këtë raport.

Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se KRRPP-ja ka përbushur obligimin për raportin që parashihet me Ligjin për prokurimin publik nr. 2003/17.

Raporti në vete përmban aktivitete të Bordit të KRPP-së, strukturën organizative të KRPP-së dhe aktivitetet e departamenteve të KRPP-së.

Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë shqyrtimit të këtij raporti ka shprehur shqetësimin e vetë lidhur me rezultatet e auditimit. Komisioni ynë shprehë brengosje për numrin e vogël të auditorëve karshi 120 autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Komisioni është i pa kënaqur me përgatitjen profesionale të zyrtarëve të prokurimit. Po ashtu komisioni ka vërejtjen në planifikimin e dobët të procesit të prokurimit. Komisioni kërkon të ndërmerren masa adekuate për ngritjen e efikasitetit më të madh të KRPP-së.

Vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportin e KRRPP-së dhanë edhe deputetët **Ramadan Kelmendi, Safete Hdërgjonaj dhe Gjylnaze Sylja**.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e raportit të KRRPP-së. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 45;
Kundër-----16;
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi raportin e Komisionit Rregullator për Prokurim Publik me vërejtjet e deputetëve.

9. Interpelanca e ministrit Ardian Gjini me kërkesë të deputetit Naser Osmani dhe dhjetë deputetëve nga rradhët e Grupit Parlamentar të LDK-së

Kryetari e ftoi parashtuesin e interpelancës ta arsyetoj atë.

Deputeti **Naser Osmani** në arsyetimin e interpelancës tha se Kosova ka një natyrë dhe vegjetacion të mirë dhe të bujshme dhe qytetarë e saj gjithmonë kanë jetuar në harmoni me natyrën. Mirëpo, kohët e fundit vërehet një shkatërrim i natyrës. Kjo ka nxitë një shqetësim te qytetarët e veçanërisht te unë, për të cilin kam kërkuar nga ministri i Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor të japë sqarime lidhur me shkatërrimin e natyrës.

Pse është lejuar shfrytëzimi dhe grryerja e tokës nga kompani të ndryshme për nxjerrje të zhavorrit dhe mineraleve tjera, pa planifikim që është shkaktuar dëmtim i rëndë i tokës dhe mjedisit, të cilat sipas ligjit janë në kompetencë të ministrisë tuaj për mirëmbajtje dhe mbikëqyrje?

Çfarë do të ndërmerrni për të ndërprerë këtë veprimtari të pa ligjshme dhe si do ta sanoni pasojat e kësaj katastrofe nga njeriu në natyrë?

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, **Ardian Gjini**, shpjegoi aktivitetet e kësaj ministrie në hartimin e legjislacionit dhe të zbatimit të tij për mbrojtjen e mjedisit, të lumenjve dhe të natyrës në përgjithësi.

Kosova është vendi më i varfër me ujëra në tërë rajonin dhe kjo na obligon ta mbrojmë dhe ta kursejmë ujin si pasuri natyrore prioritare. Edhe mbrojtja e gurëve, e zhavorrit dhe shtretërve i shërben paraprakisht mbrojtjes së pasurisë ujore.

Pas nxjerrjes së vendimit për ndalimin e shfrytëzimit të gurëve dhe të zhavorrit, që ka qenë i bazuar në Ligjin për mbrojtjen e natyrës të vitit 2005/2 dhe në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit 2003/1 kemi pasur një zhvendosje të operatorëve nga brigjet e lumenjve dhe bregu i lumit është prej cepit të lumit 50 metra, në tokën bujqësore. Pjesa e kontekstit është se toka bujqësore nuk menaxhohet nga Ministria e Mjedisit, por menaxhohet nga Ministria e Bujqësisë.

Ajo që bën Ministria është vetëm dhënia e pëlqimit mjedisor për operator, ndërsa pëlqimi mjedisor është vetëm një prej dokumenteve që i shërben Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale që ta licencojë, do të thotë Ministria nuk licencon, Ministria jep vetëm pëlqim mjedisor.

Bëj apel se çështja që e keni ngritur ju sot duhet të jetë diçka që i shërben secilit prej nesh që ta shtrimë ndikimin që e keni në komunitetin, për shkak se mbrojtja e lumenjve, mbrojtja e natyrës nuk mund të bëhet vetëm prej institucioneve.

Në debat morën pjesë këta deputetë: Fadil Gashi, **Ali Sadria dhe Xhevat Bislimi**.

Në fund, ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve.

10. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve të komisioneve funksionale të Kuvendit

Kuvendi me propozim të Kryesisë dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare mori këtë

V E N D I M

1. Në Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese emërohen:
 - deputeti **Ilaz Pireva**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
 - deputeti **Numan Baliq**, nga Grupi Parlamentar për Integrim.
2. Në Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike emërohen:
 - deputeti **Naim Jerliu**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
 - deputeti **Gjergj Dedaj**, nga Grupi Parlamentar për Integrim.

3. Në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport emërohen:

- deputetja **Naxhejje Doçi**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
- deputeti **Ramë Buja**, nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

4. Në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Mdia emërohen:

- deputeti **Ramadan Kelmendi**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
- deputeti **Sabit Rrahmani**, nga Grupi Parlamentar për Integrim.

5. Në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion emërohen:

- deputeti **Ilmi Ahmeti**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
- deputeti **Rrustem Ibishi**, nga Grupi Parlamentar për Integrim.

6. Në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor emërohen:

- deputeti **Sadudin Berisha**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
- deputetja **Sevdije Halimi** nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

7. Në Komisionin për Shëndetësi dhe Çështje Sociale emërohen:

- deputetja **Rudina Bukoshi**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
- deputeti **Ferid Agani**, nga Grupi parlamentar “Për Integrim”.

8. Në Komisionin Gatishmëri dhe Emergjencë emërohen:

- deputeti **Nimon Alimusaj**, nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe
- deputeti **Zylfi Merxha**, nga Grupi Parlamentar për Integrim.

9. Deputetja **Brikenda Kryeziu** emërohet anëtare e Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritime Euroatlantike, në vend të deputetit Ilmi Ahmeti.

Shënim: Pjesë përbërëse e këtij procesverballi është transkripti nga kjo seancë.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 17,00.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale